



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E DREJTËSISË  
MINISTRI

2978/1  
Nr. \_\_\_ Prot.

19.04.  
Tiranë, më \_\_\_/\_\_\_/2023

**URDHËR**

**NR. 297, DATË 19/04/2023**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 2791/9 DATË 25.04.2017,  
“PËR MARRJEN NË DORËZIM TË REGJISTRAVE DHE AKTEVE NOTERIALE TË  
ISH-NOTERËVE PREL PËRKOLAJ DHE HYSEN SENA”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6 dhe 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 110/2018, “Për Noterinë”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 167, datë 10.06.2020 “Për marrjen në dorëzim të akteve noteriale, regjistrave dhe vulave të noterit”, si dhe Urdhrit nr.168, datë 10.06.2020 “Për evidentimin dhe marrjen në dorëzim të arkivave të padorëzuara ndër vite”,

**URDHËROJ:**

1. Ndryshimin e pikës 2 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017 me përmbajtje si vijon:

“2.Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:

- a. Znj. Erisa Sulçe, specialiste në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
- b. Znj. Eda Shehu, specialiste në Sektorin e Monitorimit të Veprimtarisë Noteriale;
- c. Znj. Gentiana Brati, përfaqësuese e Dhomës Kombëtare të Noterisë;
- d. Znj. Albana Spahiu, përfaqësuese e Degës Vendore të Noterisë Tiranë.”

2. Ndryshimin e pikës 3 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017 me përmbajtje si vijon:

“3.Arkiva t’i jepet në ruajtje dhe administrim, brenda një afati 60 ditor, noteres së Degës Vendore të Noterisë Tiranë znj. Margalina Dauti, pas verifikimit nga ana e anëtarëve të komisionit të marrjes në dorëzim të arkivit, se noteria plotëson kushtet teknike për mirëmbajtjen e dokumenteve të arkivit dhe kryerjen sa më të shpejtë e cilësor të shërbimit ndaj të interesuarve për lëshimin e kopjeve dhe shkurtimin e akteve.”

3. Pas pikës 3 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017 shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:

“4.Komisioni i ngritur në zbatim të këtij urdhri kryen dorëzimin e regjistrave dhe akteve noteriale noteres Margalina Dauti, të caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Tiranë, si dhe kryen asgjësimin e vulës së thatë dhe vulës së njomë, të ish-noterëve Prel Përkolaj dhe Hysen Sena.”

4. Ndryshimin e pikës 4 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017 si pikë 5;

5. Ndryshimin e pikës 5 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017, me numërtim dhe përmbajtje si vijon:

“6.Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë të marri masat e nevojshme për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.”

6. Ndryshimin e pikës 6 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017 si pikë 7;

7. Shtimin e pikës 8 të Urdhrit nr. 2791/9 datë 25.04.2017, me përmbajtje si vijon

“8.Marrjen e masave nga Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri personave përgjegjës si dhe ish-noterëve Hysen Sena dhe Prel Perkolaj.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**ULSI MANJA**

